



## ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 dhe Nenit 31 paragrafit 3 të Ligjit nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022), Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

### RREGULLORE PËR LARTËSINË DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE TË INXHINIERIT TË LICENCUAR

#### KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i lartësisë dhe mënyrës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale për dëmet të cilat mund t'i shkaktojë inxhinieri i licencuar (në tekstin e mëtejmë: inxhinieri) gjatë kryerjes së veprimeve të lejuara me licencë.

##### Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën e Inxhinierëve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Oda) dhe organet e saj si dhe të gjithë inxhinierët që ushtrojnë veprimtarinë profesionale në Republikën e Kosovës.

##### Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
  - 1.1. **Primi i sigurimit** – çmimi për mbulesën e sigurimit i përcaktuar në policën e sigurimit.
  - 1.2. **Polica e sigurimit** – kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale e inxhinierit, me të cilën dëshmohet kontraktimi i sigurimit.
  - 1.3. **Mbulesa e sigurimit** – Shuma e mbuluar nga siguruesi për pagesën e dëmit të shkaktuar nga inxhinieri në kuptim të dispozitave ligjore të përgjegjësisë juridiko-civile.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L - 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejmë: Ligji në fuqi).

3. Emrat në njëren gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjeter, pa diskriminim.

## **KAPITULLI II** **SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PROFESSIONALE**

### **Neni 4**

#### **Detyrimi për sigurimin e përgjegjësisë profesionale**

1. Inxhinieri i licencuar sigurohet për përgjegjësinë profesionale sipas llojit dhe shkallës së rezikut për dëmin i cili do t'i shkaktohej investitorit ose personave të tjerë nga veprimet apo mosveprimet e inxhinierit.

2. Dëmi nga paragrafi 1 përfshin dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e gabimit profesional të inxhinierit, që përfshin shkelje apo mos-zbatim të rregullave të profesionit të vërtetuara me standarde profesionale, gjegjësish mos-zbatimin ose mos-veprimin me kujdes sipas detyrave të inxhinierit si profesionist.

### **Neni 5**

#### **Lartësia e sigurimit të përgjegjësisë profesionale**

1. Lartësia e mbulesës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar përcaktohet në bazë të marrëveshjes së Odës me kompaninë e licencuar të sigurimit sipas Nenit 7, por nuk mund të jetë më e vogël se njëzetmijë (20.000) euro.

2. Mbulesa e sigurimit të përgjegjësisë profesionale nga paragrafi 1 përfshin shumën maksimale që paguhet nga siguruesi për të kompensuar dëmin e shkaktuar në një rast të caktuar.

### **Neni 6**

#### **Përgjegjësia solidare**

Arkitekti i licencuar dhe inxhinieri i licencuar në fushën e ndërtimit përgjigjen në mënyrë solidare për punën dhe projektin e tyre të përbashkët të zhvilluar.

### **Neni 7**

#### **Sigurimi i përgjegjësisë profesionale përmes Odës**

1. Sigurimi i përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar që është anëtar i Odës, bëhet përmes Odës.

2. Në zbatim të paragrafit 1, Oda lidh marrëveshje me kompaninë e licencuar të sigurimit, në të cilën përcaktohen kushtet, primi i sigurimit, lartësia e sigurimit dhe procedurat e kompensimit të dëmit të shkaktuar.

3. Sigurimi i detyrueshëm profesional i inxhinierit të licencuar përmes Odës nuk përjashton mundësinë e sigurimit shtesë individual të përgjegjësisë profesionale të inxhinierit të licencuar.

**Neni 8**  
**Detyrimet e inxhinierit të licencuar**

1. Inxhinieri i licencuar që është anëtar i Odës, paguan shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale sipas marrëveshjes të lidhur në mes të Odës me kompaninë e sigurimit.

2. Inxhinieri i licencuar që paguan shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale pajiset me policën e sigurimit.

3. Mos-pagesa e shumës së sigurimit të përgjegjësisë profesionale nga inxhinieri i licencuar përbën shkelje të rëndë disiplinore.

**Neni 9**  
**Sigurimi i përgjegjësie profesionale të inxhinierit të cilit i njihet licenca profesionale e lëshuar jashtë Republikës së Kosovës**

1. Inxhinierit të cilit i njihet licenca profesionale e lëshuar jashtë Republikës së Kosovës në përputhje me Rregulloren përkatëse të Odës, i njihet dëshmja e sigurimit të përgjegjësisë profesionale e lëshuar në shtetin tjetër, në rast se ky sigurim mbalon veprimtarinë profesionale të inxhinierit në territorin e Republikës së Kosovës.

2. Në rast të pambulueshmërisë së sigurimit të përgjegjësisë profesionale për veprimtarinë në territorin e Republikës së Kosovës, inxhinieri paguan shumën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale në përputhje me Nenin 8.

**KAPITULLI III**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca

Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës